



Në bazë të nenit 19, paragrafi 4, dhe të nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.06.2005, mori

**VENDIM  
PËR  
NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES  
PËR ORGANIZIMIN E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE  
NË KOMUNËN E PRISHTINËS**

**Neni 1**

Në Rregulloren për organizimin e transportit të udhëtarëve në komunën e Prishtinës 01 nr.110-2119, të datës 08.12.2003, neni 2, paragrafi 1, “linja nr.5” ndryshohet dhe bëhet:

- Linja nr.5: Kodra e Diellit (zona e jugut) – Sefali.

**Neni 2**

Në nenin 2, paragrafi 1, pas linjës nr.6, shtohet linja e re:

- Linja nr.6A: lagjja “Fidanishtja”- sheshi “Idriz Seferi” (te Rrethi).

**Neni 3**

Në nenin 2, paragrafi 1, pas linjës nr.7-A, shtohen dy linja të reja:

- Linja nr.7-A1: rruga “Xhavit Ahmeti”- rruga “Muharrem Fejza” (Lagjja e Spitalit) dhe
- Linja nr.7-A2: rruga “Hasan Remniku”- rruga “Muharrem Fejza”(Arkivi i Kosovës).

**Neni 4**

Në nenin 2, paragrafi 1, linja nr.13 fshihet dhe zëvendësohet me linjën e re:

- **Linja nr.13: Lagjja e Llumnicëve (Barilevë) – Stacioni hekurudhor (Prishtinë)**

**Neni 5**

Në nenin 2, paragrafi 1, linja nr.22: Llapnasellë-Prishtinë ndryshohet dhe bëhet:

- Linja nr.22: Llapnasellë-Çagllavicë-Prishtinë.

Në nenin 2, pas linjës nr.22, shtohet linja nr.22A: Graçanicë-Prishtinë.

## Neni 6

Në nenin 2, paragrafi 2, itinerari i linjës nr.5 ndryshohet dhe bëhet:

Në ardhje:

- - Nisja fillon nga Kodra e Diellit (zona e jugut), në fillim të rr."Hyzri Talla",majtas në rr."Xheladin Rekaliu", vazhdon në rr."Fehmi Lladrovci", djathtas në rr. "Bulevardi i Dëshmorëve", djathtas në rr."Eqrem Çabej", majtas në rr. "Agim Ramadani", djathtas në rr."Ibrahim Lutfiu", vazhdon në rr."Nazim Gafurri", pastaj rr. "Shpëtim Robaj" dhe përfundon në lagjen "Sefalia"( brenda në lagje).

Vendndaljet:

1. Rr."Hyzri Talla" – në fillim të rrugës,
2. Rr."Hyzri tall" – para Drejtorisë së Rrugëve,
3. Rr."Hyzri Talla" – afër Kopështit të fëmijëve,
4. Rr. "Fehmi Lladrovci" – te Spitali,
5. Sheshi "Idriz Seferi" – te Rrethi,
6. Rr. "Bulevardi i Dëshmorëve" – te Tregu i Ulpianës,
7. Rr. "Eqrem Çabej" – te Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore",
8. Rr."Agim Ramadani" – afër Fakultetit Ekonomik,
9. Rr."Agim Ramadani" – prapa Teatrit Kombëtar,
10. Rr."Ibrahim Lutfiu" –afër gjimnazit "Sami Frashëri",
11. Rr."Nazim Gafurri" – te kisha,
12. Rr."Nazim Gafurri" –te vetshërbimi në Taslixhe,
13. Rr."Nazim Gafurri" – Tauk-Bahçe,
14. Rr."Shpëtim Robaj" – Shkolla Normale,
15. Lagjja "Sefalia".

Në kthim:

- Nisja fillon nga lagjja "Sefalia", majtas në rr."Shpëtim Robaj",në rr."Nazim Gafurri", majtas në rr."Ibrahim Lutfiu", majtas në rr."Agim Ramadani", djathtas në rr."Eqrem Çabej", majtas në rr. "Bulevardi i Dëshmorëve", Rrethi qarkor, rr. "Fehmi Lladrovci", vazhdon rr. "Xheladin Rekaliu", majtas në rr."Hyzri Talla" dhe përfundon në fund të kësaj rruge, në Kodrën e Diellit (zona e jugut).

Vendndaljet:

1. Lagja "Sefalia",
2. Rr."Shpëtim Robaj"- Shkolla Normale,
3. Rr."Nazim Gafurri"- Tauk-Bahçe,
4. Rr."Nazim Gafurri"- te vetshërbimi në Taslixhe,
5. Rr."Nazim Gafurri"- te kisha,
6. Rr."Ibrahim Lutfiu"- të SHM Teknike,
7. Rr."Agim Ramadani"- prapa Teatrit Kombëtar,
8. Rr."Agim Ramadani"- afër Fakultetit të Arteve,
9. Rr."Eqrem Çabej" te Fakulteti i Shk. Mat.-Natyrore,
10. Rr."Bulevardi i Dëshmorëve"- te PTK-ja,

11. Sheshi "Idriz Seferi" – te Rrethi,
12. Rr."Fehmi Lladrovci" – te Spitali,
13. Rr."Xheladin Rekalju" – të Konviktet e Studentëve,
14. Rr."Hyzri Talla"- para Drejtorisë së Rrugëve,
15. Rr."Hyzri Talla"- në fund të kësaj rruge".

### Neni 7

Në nenin 2, paragrafi 2, pas itinerarit të linjës nr.6, shtohet itinerari i linjës së re 6A, me këtë tekst:

#### **"Linja nr.6-A: lagjja "Fidanishtja" - sheshi "Idriz Seferi" (te Rrethi).**

Në ardhje:

- Nisja fillon nga lagjja "Fidanishtja", në rr."Ahmet Krasniqi", djathtas në rr."Tirana", majtas në rr."Bill Klinton", djathtas në "Bulevardin e Dëshmorëve" dhe përfundon në sheshin "Idriz Seferi" (Rrethi çarkor).

Vendndaljet:

1. Lagjja "Fidanishtja",
2. Lagjja "Fidanishtja"- para KFOR-it,
3. Rr."Ahmet Krasniqi"- te Zyra austriake,
4. Rr."Ahmet Krasniqi"- te rr."Ekrem Rexha",
5. Rr."Tirana"- të Tregu,
6. Rr."Tirana"- te Stacioni hekurudhor,
7. Rr."Bill Klinton"- Dardania,
8. "Bulevardi i Dëshmorëve",
9. Sheshi "Idriz Seferi" (Rrethi çarkor).

Në kthim:

- Nisja fillon nga sheshi "Idriz Seferi" (Rrethi çarkor), vazhdon në "Bulevardin e Dëshmorëve", majtas në rr."Bill Klintoni", djathtas në rr."Robert Doli", djathtas në rr."Kosta Novakoviqi", vazhdon drejt rr."Luan Haradinaj", majtas në rr."Fehmi Agani", majtas në rr."Tirana", djathtas në rr."Ahmet Krasniqi" dhe përfundon në lagjen "Fidanishtja".

Vendndaljet:

1. Sheshi "Idriz Seferi" (Rrethi çarkor),
2. "Bulevardi i Dëshmorëve"- te PTK-ja,
3. Rr."Robert Doli"- afër udhëkryqit me rr. "Mbreti Zog",
4. Rr."Luan Haradinaj"- Pallati i Rinisë,
5. Rr."Fehmi Agani"- te Lulishtja,
6. Rr."Ahmet Krasniqi"- të restoranti "Amadeus",
7. Rr."Ahmet Krasniqi"- të Zyra austriake,
8. Lagjja "Fidanishtja"- afër KFOR-it,
9. Lagjja "Fidanishtja".

Në këtë linjë bartja e udhëtarëve do të bëhet me automjete 8+1 ulëse, me lejen e Kuvendit të Komunës së Prishtinës".

## Neni 8

Në nenin 2, paragrafi 2, pas itinerarit të linjës nr. 7-A, shtohet itinerari i linjës 7-A1, me këtë tekst:

### **“Linja Nr.7-A1: rr.”Xhavit Ahmeti” – rr.“Muharrem Fejza” (Lagjja e Spitalit).**

Në ardhje:

Nisja fillon nga rr.”Xhavit Ahmeti”( nga bregu), djathtas në rr. “Nazim Gafurri”, vazhdon në rr. “Ibrahim Lutfiu”, majtas në rr. “Agim Ramadani”, djathtas në rr.”Fehmi Lladrovci”, majtas në rr. “ Muharrem Fejza” dhe përfundon te Arkivi i Kosovës.

Vendndaljet:

1. Rr.”Xhavit Ahmeti” – në fillim të rrugës së asfaltuar,
2. Rr.”Xhavit Ahmeti – mesi i rrugës
3. Rr.”Nazim Gafurri” – Tauk-Bahçe,
4. Rr.”Nazim Gafurri” – të vetshërbimi (Taslixhe),
5. Rr.”Nazim Gafurri” – të kisha,
6. Rr.”Ibrahim Lutfiu” – afër SHM Teknike
7. Rr.”Agim Ramadani” – prapa Teatrit Kombëtar
8. Rr.”Agim Ramadani” – Fakulteti Ekonomik
9. Rr.”Agim Ramadani” – të Konviktet e St.,
10. Rr.”Fehmi Lladroci” – afër udhëkryqit me rr.”M.Fejza”,
11. Rr.”Muharrem Fajza” – Arkivi i Kosovës.

Në kthim:

Nga Arkivi Kosovës, rr.”Muharrem Fejza”, djathtas rrugës “Fehmi Lladroci”, majtas rr.”Agim Ramadani”, djathtas rr.”Ibrahim Lutfiu”, vazhdon rr.”Nazim Gafurri”, majtas rr. ”Xhavit Ahmeti” dhe përfundon në mbarim të asfaltit.

Vendndaljet:

1. Rr.”Muharrem Fejza” – Arkivi i Kosovës,
2. Rr.”Fehmi Lladroci” – afër udhëkryqit me rr.”M.Fejza”
3. Rr.”Agim Ramadani” – të Konviktet e St.,
4. Rr.”Agim Ramadani” – Fakulteti Ekonomik
5. Rr.”Agim Ramadani” – prapa Teatrit Kombëtar
6. Rr.”Ibrahim Lutfiu” – afër SHM Teknike
7. Rr.”Nazim Gafurri” – të kisha,
8. Rr.”Nazim Gafurri” – Taslixhe,
9. Rr.”Nazim Gafurri” - Tauk-Bahçe,
10. Rr.”Xhavit Ahmeti” – mesi i rrugës
11. Rr.”Xhavit Ahmeti” – në fund të rrugës .”

Në nenin 2, paragrafi 2, pas itinerarit të linjës 7-A1, shtohet itinerari i linjës 7-A2 me këtë tekst:

**“Linja 7-A2: rr.”Hasan Remniku” – rr.”Muharrem Fejza”.**

Në ardhje:

- Nisja fillon nga rr.”Hasan Remniku”, rr.”Haxhi Zeka”, rr. “Xheladin Kurbaliu”, djathtas në rr. “Nazim Gafurri”, rr.”Ibrahim Lutfiu”, majtas në rr. ”Agim Ramadani”, djathtas në rr. ”Fehmi Lladrovci”, majtas në rr. ”Muharrem Fejza”, te Arkivi i Kosovës.

Vendndaljet:

1. Rr. “Hasan Remniku”,
2. Rr. “Haxhi Zeka” – te trafoja,
3. Rr. “Haxhi Zeka” –te udhëkryqi me rr. “Xheladin Kurbaliu”,
4. Rr. “Ibrahim Lutfiu” – te SHMT “19 Nëntori”,
5. Rr. “Agim Ramadani” – te Konviktet,
6. Rr. “Agim Ramadani” – te Fak. Ekonomik,
7. Rr. “Agim Ramadani” – prapa Teatrit Kombetar,
8. Rr. “Fehmi Lladrovci” – te Spitali,
9. Rr. “Muharrem Fejza” – te Arkivi i Kosovës.

Në kthim:

- Nisja fillon nga Arkivi i Kosovës, rr.”Muharrem Fejza”, djathtas rr.”Fehmi Lladrovci”, majtas rr.”Agim Ramadani”, djathtas rr.”Ibrahim Lutfiu”, rr.”Haxhi Zeka”, përfundon në rr.”Hasan Remniku”.

Vendndaljet:

1. Rr.”Muharrem Fejza” – Arkivi i Kosovës,
2. Rr.”Fehmi Lladrovci” – afër udhëkryqit me rr.”M.Fejza”,
3. Rr.”Agim Ramadani” – te Konviktet e St.,
4. Rr.”Agim Ramadani” – prapa Teatrit Kombëtar,
5. Rr.”Agim Ramadani” – Fakulteti Ekonomik,
6. Rr.”Ibrahim Lutfiu” – te gjimnazi “ Sami Frashëri”,
7. Rr.”Haxhi Zeka” – të udhëkryqi me rr.”Xheladin Kurbaliu”,
8. Rr.”Haxhi Zeka” – te trafoja,
9. Rr.”Hasan Remniku”- kryqëzimi me rr.”Haxhi Zeka”,
10. Rr.”Hasan Remniku” – në përfundim të asfaltit.”.

Në nenin 2, paragrafi 2, ndryshohet itinerari i linjës 9 dhe bëhet:

Linja nr.9: Mat-Pishinë (Gërmi)

Në ardhje:

- Nga lagjja “Mati”, rr. ”Isa Kastrati”, majtas në rr.”Xheladin Hana”, vazhdon rr.”Rrahim Beqiri”, rr.”Hilmi Rakovica”, rr. “Enver Maloku”, rr.”Xheladin Rekalii”, rr. “Fehmi Lladrovci”, sheshi “Idriz Seferi” (rrethi qarkor), dalja në rr.”Bulevardi i Dëshmorëve”, drejt në rr. “Nënë Tereza”, te hoteli “Grand”, majtas në rr. “Garibaldi”, djathtas në rr.”Luan Haradinaj”, rr. “Migjeni”, djathtas në rr. “UÇK-ja”, rr.”Ilir Konushëci”, rr. “Agim Ramadani”, majtas në rr. “Ibrahim Lutfiu”, djathtas në rr.”Nazim Gafurri” dhe përfundon në platon para pishinës, në Rr. “Shpëtim Robaj”.

#### Vendndaljet:

1. Kryqëzimi, poshtë-Lagjja “Mati”,
2. Kryqëzimi me rr. për Lugmir,
3. Varrezat, në fund,
4. “Ali- Petroll”, pas pompës,
5. “Përparimi”, depo,
6. Furra, para kryqz. me rr. “Rrahim Beqiri”,
7. Rr.,Rrahim Beqiri” – Banesat e Bardha,
8. Rr.”Rrahim Beqiri”-afër tregut,
9. Rr.,Rrahim Beqiri”- te Xhambazët,
10. Rr.,Enver Maloku”- te furra “Qerimi”,
11. Rr., Xheladin Rekaliu” – Konviktet e studentëve,
12. Rr. „Fehmi Lladrovci” – përballë hyrjes së Qendrës Klinike Universitare,
13. Sheshi „Idriz Seferi” – Rrethi qarkor.
14. Rr. „Bulevardi i Dëshmorëve” – te Tregu i Ulpianës,
15. Rr. „Nënë Tereza” – te “Radio-Kosova”,
16. Rr. „Garibaldi” – te BPK-ja,
17. Rr.,Luan Haradinaj” – përballë Pallatit të Rinisë,
18. Rr. „Migjeni” – te ndërtesa e OSBE-së,
19. Rr. „Agim Ramadani” – para Kadastrit komunal,
20. Rr. „Ibrahim Lutfiu” – gjimnazi „Sami Frasheri”,
21. Rr.,Nazim Gafurri” – te kisha,
22. Rr.,Nazim Gafurri” – te vetshërbimi (Taslixhe),
23. Rr.,Nazim Gafurri” – Tauk- Bahçe,
24. Rr. „Shpëtim Robaj” – Shkolla Normale,
25. Rr. „Shpëtim Robaj” – pishina e Gërmisë,

#### Në kthim:

- Nga platoja e pishinës, në rr. “Shpëtim Robaj”, në rr.”Nazim Gafurri”, majtas në rr. “Ibrahim Lutfiu”, rr. “Agim Ramadani”, para Kuvendit të Kosovës, djathtas në shiritin e rezervuar për automjete prioritare në Rr. “Nënë Tereza”, drejt në rr. “Bulevardi i Dëshmorëve”, sheshi “Idriz Seferi” (Rrethi qarkor), dalje në rr. “Fehmi Lladrovci”, rr. “Xheladin Rekaliu”, rr. “Enver Maloku”, rr. “Armend Daci”, djathtas në rr. “Rrahim Beqiri”, vazhdon rr. ”Xheladin Hana”, djathtas në rr. ”Isa Kastrati” dhe përfundon në lagjen “Mati”.

#### Vendndaljet:

1. Pishina e Gërmisë,
2. Shkolla Normale,
3. Rr.,Nazim Gafurri” – Tauk- Bahçe,
4. Taslixhe – te vetshërbimi,
5. Rr.,Nazim Gafurri” – te kisha,
6. Shkolla e Mesme Teknike,
7. Sheshi “Skënderbej”,
8. Shkolla fillore “Faik Konica”,
9. Afër ndërtesës së PTK-së,
10. Sheshi “Idriz Seferi” – Rrethi qarkor,

11. Rr. "Fehmi Lladrovci" – përballë hyrjes së QKU-së,
12. Rr. "Xheladin Rekalii" – Konviktet e studentëve,
13. Rr."Enver Maloku" – furra "Qerimi",
14. Rr."Armend Daci" – te Xhambazët,
15. Rr."Rrahim Beqiri"-Banesat e Bardha,
16. Furra – kryqz. me rr."Isa Kastrati",
17. "Përparimi" – depo,
18. "Ali Petroll",
19. Varrezat,
20. Kryqëzimi me Lugmir,
21. Lagjja "Mati".

## Neni 9

Në nenin 2, paragrafi 2, pas itinerarit të linjës nr.12, shtohet itinerari i linjës 13:

### **"Linja nr.13: Lagja e Llumnicëve (Barilevë)-Stacioni hekurudhor (Prishtinë)**

Në ardhje:

- Nisja fillon nga Lagjja e Llumnicëve, Pirevë, djathtas në magjistralën Besianë-Prishtinë, në rr."Vëllezërit Fazliu", rr."Ilir Konushefci", djathtas në rr."UÇK-ja", drejt në rr."Tirana" dhe përfundon në Stacionin hekurudhor.

Vendndaljet:

1. Lagjja e Llumnicëve – te varrezat,
2. Kryqëzimi me magjistrale,
3. Vranidoll,
4. Besi,
5. Të Tregu i bagëtime,
6. Rr."Vëllezërit Fazliu" te Hidroteknika,
7. Rr."Ilir Konushefci"- te Xhamia e Llapit,
8. Rr."UÇK-ja"- "te Qafa",
9. Rr."Tirana", pas kryqëzimit me rr."A. Krasniqi",
10. Rr."Tirana" – Stacioni hekurudhor.

Në kthim:

- Nisja fillon nga Stacioni hekurudhor, në rr."Tirana", pastaj rr."UÇK-ja", majtas në rr."Ilir Konushefci", djathtas rr."Vëllezërit Fazliu" dhe vazhdon rrugës magjistrale Prishtinë-Besianë, në Pirevë kthet majtas për në Lagjen e Llumnicëve, ku dhe përfundon kjo linjë.

Vendndaljet:

1. Rr."Tirana" – Stacioni hekurudhor,
2. Rr."Tirana" – para kryqëzimit me rr."A.Krasniqi",
3. Rr."UÇK-ja" – "te Qafa"
4. Rr."Ilir Konushefci" – Xhamia e Llapit,
5. Rr."Vëllezërit Fazliu" – te Hidroteknika,
6. Te Tregu i bagëtime,
7. Besi,
8. Vranidoll,
9. Kryqëzimi me magjistrale,
10. Lagjja e Llumnicëve – te varrezat."

### **Neni 10**

Në nenin 2, paragrafi 2, pas itinerarit të linjës nr.21, ndryshohet itinerari i linjës 22 dhe bëhet:

#### **"Linja nr.22: Llapnasellë-Çagllavicë-Prishtinë.**

Në ardhje:

- Nisja fillon nga Llapnasella, në Çagllavicë, përmes rrugës magjistrale Ferizaj-Prishtinë, te Rrethi qarkor (sheshi "Idriz Seferi"), rr."Fehmi Lladrovci", rr."Agim Ramadani" (prapa Teatrit Kombëtar).

Vendndaljet:

1. Llapnasellë,
2. Çagllavicë,
3. Rrethi qarkor,
4. Te Spitali (rr. "M. Fejza"),
5. Te Qendra e Studentëve,
6. Te Fakulteti Ekonomik,
7. Te Teatri Kombëtar.

Në kthim:

- Nisja fillon prapa Teatrit Kombëtar, bulevardi "Nëna Terezë", bulevardi "Deshmorët e Kombit", në magjistrалën Prishtinë-Ferizaj, vazhdon për Çagllavicë dhe përfundon në qendër të fshatit Llapnasellë.

Vendndaljet:

1. Teatri Kombëtar,
2. Sheshi "Skënderbj",
3. Përball Radio Prishtinës,
4. Te Posta e re,
5. Te Rrethi qarkor,
6. Çagllavicë,
7. Llapnasellë".

Transporti në këtë linjë do të bëhet vetëm me autobusë.



Në nenin 2, par.2 pas itinerarit të linjës nr.22, shtohet linja e re 22A dhe bëhet:

**Linja nr.22A: Graçanicë – Prishtinë**

Në ardhje :

Nga Graçanica, në Veternik, përmes rrugës magjistrale Gjilan-Prishtinë, te Rrethi qarkor (sheshi “Idriz Seferi”, rr. “Fehmi Lladrovci”, rr. Agim Ramadani”, djathtas në rr.”Arkitekt Karl Gega”.

Vendndaljet:

1. Graçanicë - Hendikos,
2. Hajvali,
3. Rrethi qarkorë,
4. Te Spitali, (rr. “M Fejza”),
5. Te Qendra e Studentëve,
6. Rr “Arkitekt Karl Gega.

Në kthim

Nisja fillon në rr. “Ali Pashë Tepelena”, majtas në rr. “Gazmend Zajmi”, djathtas në rr. “Rexhep Mala”, djathtas në rr. “Eqrem Çabej”, majtas në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, “Rrethi Qarkorë”, në magjistralen Prishtinë- Ferizaj, vazhdon majtas në magjistralen Prishtinë – Gjilan dhe përfundon në Graçanicë.

Vendndaljet:

1. Rr. “Ali Pashë Tepelena”,
2. Fakulteti i Matematikës,
3. Te Posta e Re,
4. Te Rrethi Qarkorë
5. Hajvali,
6. Graçanicë - Hendikos.

Transporti me këtë linjë do të bëhet me automjetet 8+1 ulëse.

**Neni 11**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01 Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2005**

**KRYETARI I KUVENDIT  
Ismet Beqiri**